



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 232, Datë 27.10.2020

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR SHQYRTIMIN E RASTEVE TË QËNDRIMIT PUBLIK TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NË MBROJTJE TË FIGURËS SË PROKURORIT

Bazuar në nenin 160 / pika 6 dhe 14, si dhe nenit 185 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I :

1. Ngritjen e Komisionit Ad Hoc për shqyrtimin e rasteve të qëndrimit publik të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në mbrojtje të figurës së prokurorit, të përbërë nga Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Kryetarët e Komisioneve të Përhershëm.
2. Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është dhe Kryetari i këtij Komisioni.
3. Komisioni, me nismë ose bazuar në kërkesat e prokurorëve, mund të bëjë deklarata publike në mbrojtje të prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI



Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, Godina Poli I Drejtësisë, Tiranë

www.klp.al/ adresa e mail; info@klp.al